



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 42 regjistër (JR)
Datë 14.09.2023

Nr. 37 i vendimit
Datë 19.07.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 19.07.2024, ora 10:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 42/2023 (JR), datë 14.09.2023, që i përket:

ANKUES

Subjekti i rivlerësimit Përparim Vukaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, përfaqësuar me prokurë nga Av. Aleks Nikëhasani.

OBJEKTI:

Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 683, datë 10.07.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Vukaj.

BAZA LIGJORE:

Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, Ç, D, F e në vijim të Aneksit të Kushtetutës, ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Përparim Vukaj ka ushtruar detyrën si prokuror dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Përparim Vukaj, bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 683, datë 10.07.2023.
3. Komisioni, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 683, datë 10.07.2023, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimi Përparim Vukaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.
4. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë Av. Aleks Nikëhasani, iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, (në vijim referuar “Kolegji”), me ankim kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 683, datë 10.07.2023, me pretendimin se vendimi bie ndesh me ligjin material dhe procedural, si dhe është rezultat i cenimit të parimeve kushtetuese për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi objekt ankimi është rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të rezultuara dhe të vërtetuara gjatë procesit administrativ për hetimin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë.
5. Subjekti i rivlerësimit bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet 51 dhe 53/b të ligjit nr. 49/2012, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 683, datë 10.07.2023.*
 - *Urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Përparim Vukaj edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.*
 - *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Përparim Vukaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.*

6. Në kuadër të përgatitjes së çështjes për gjykim në Kolegj, nga aksesimi i të dhënave të gjendjes civile të shtetasve në Republikën e Shqipërisë, referuar Regjistrin Kombëtar të mbajtur nga Drejtoria e Gjendjes Civile, u konstatua se për shtetasin Përparim {***} Vukaj, identifikuar me nr. personal {***}, ishte përpiluar akti i vdekjes nr. {***}, datë 11.12.2023, sipas së cilit konfirmohej se ky shtetas kishte ndërruar jetë më datë 09.12.2023.
7. Në vijim Kolegji iu drejtua Këshillit të Lartë të Prokurorisë me shkresën nr. {***} prot., datë 27.06.2024, duke kërkuar informacion lidhur me magjistratin e sipërcituar. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me anë të shkresës së tij nr. {***} prot, datë 05.07.2024, informoi Kolegjin se: *[...] pas verifikimeve të kryera në dosjen personale të Përparim Vukaj, Akti i Vdekjes nr. {***}, datë 11.12.2023, i referohet magjistratit Përparim Vukaj, me numër personal {***}. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. {***}, datë 14.12.2023, ka miratuar ndërprerjen pa vendim përfundimtar të vlerësimit etik dhe profesional për prokurorin Përparim Vukaj.* Bashkëlidhur kësaj shkrese, Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcolli edhe kopje të vendimit të sipërcituar, si dhe certifikatën e vdekjes së magjistratit të ndjerë.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Përparim Vukaj, dhe për të cilin nëpërmjet ankimit kërkohet ndryshimi i tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
10. Trupi gjykues vëren se referuar të dhënave të marra nga databaza shtetërore e gjendjes civile dhe akteve zyrtare të administruara, subjekti i rivlerësimit pas ushtrimit të ankimit në Kolegj ka ndërruar jetë. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë procesi i rivlerësimit kalimtar të magjistratëve në Republikën e Shqipërisë, i zhvilluar në bazë të parashikimeve Kushtetuese të nenit 179/b, Aneksit të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016, ka natyrë

administrative dhe karakter personal, të lidhur ngushtësisht me detyrën e ushtuar nga subjektet e rivlerësimit, pa prodhuar pasoja juridike tek trashëgimtarët, fakti i konstatuar më sipër, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative¹ çmohet se pamundëson shqyrtimin e çështjes së juridiksionit të rivlerësimit nr. 42/2023, datë 14.09.2023, me një vendimmarrje përfundimtare, lidhur me ankimin e ushtruar nga i ndjeri, kundër vendimit të Komisionit nr. 683, datë 10.07.2023.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 93, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, të ndjerin, Përparim Vukaj pa një vendim përfundimtar për çështjen.

U shpall sot, më datë 19.07.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

¹ Neni 93 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton shprehimisht:

- **Neni 93 – Vdekja e palës, mbarimi i personit juridik**

1. Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen. Në çdo rast tjetër, nëse organi publik vlerëson nëse pjesëmarrja e palës është e domosdoshme, pezullon procedurën për kohësisht deri në identifikimin e trashëgimtarëve.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, edhe në rastin e mbarimit të personit juridik, kur ky i fundit është palë, organi publik deklaron përfundimin e procedurës administrative pa marrë një vendim përfundimtar.